




31. 12. 2026

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe komfor nenit 29 të Rregullores së ARRU Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë qershor 2020, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifar të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)



1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e N. H "Ibër Lepenc" sh. a Prishtinë (ARRU/UTSH-18/08/2026), për aktivitetet themelore të shërbimit të ujit të patrajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përfshihet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të N. H "Ibër Lepenc" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 30 dhe 31 të Rregullores 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. N. H "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara nga ARRU-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose t'u dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit ; www.arru-rks.org.
5. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
6. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2026 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2026 (01.01-31.12.2026).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRU

1 x 1 Departamentit të Tarifave

1 x 1 Krye shefit Ekzekutiv të N. H "Ibër Lepenc"



Hajrije Morina
Drejtoreshë e ARRU



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-18/08/2026

URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

N. H "IBËR LEPENC" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2026

E aplikueshme për:

KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë
KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë

Pasqyra e tarifave të shërbimit

NH "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifatat e Shërbimit, për furnizim të ujit me shumicë, të pa trajtuar, gjatë periudhës tarifore 01. 01 deri më 31. 12. 2026, sikurse janë dhënë në tabelën e më poshtme:

Tabela 1: Tarifatat e ujit të pa trajtuar me shumicë

<i>Numri rendor</i>	<i>KRU-të</i>	<i>Njësia tarifore</i>	<i>Viti 2025</i>
1	Mitrovica	€/m ³	0.0199
2	Prishtina	€/m ³	0.0427

Shënim:

Për KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë, tarifatat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipoll të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balinc të Vushtrrisë.

Për KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë, tarifatat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën përpunimit të ujit në Drenas.